



MASA DHE AKTIVITETE TË PROPOZUARA
SI PJESË E MATRICËS SË PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 – 2030

MASA DHE AKTIVITETE	PËRGJEGJËS	MBËSHTETTËS	AFATI KOHOR	TREGUESIT
1. FUQIZIMI EKONOMIK				
1.1. Përcaktimi nga bashkia i fushave prioritare të zhvillimit ekonomik, ku do fokusohet vëmendja për periudhën 2025 – 2030, përmes hartimit të Planit Vendor të Zhvillimit Ekonomik, me ndjeshmëri gjinore	Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Transportit Kabineti i Kryetarit	Përfaqësues/e të drejtorive që do caktohen në Grupin e Punës për përgatitjen e këtij plani	2025 (për përcaktimin e fushave prioritare)	Fushat prioriare të zhvillimit ekonomik të përcaktuara. Një vendim për fillimin e punës për hartimin e Planit Vendor të Zhvillimit Ekonomik i përgatitur.
1.2. Zgjerimi i grupit të përfitueseve gra dhe të reja, nga grupe të cënueshme ¹ vecanërisht nga zonat rurale ² , që përfitojnë lehtësira fiskale për sipërmarrjet fillestare (start-up), përmes heqjes së detyrimit për pagesën e tarifave vendore për dy vitet e para të funksionimit të sipërmarrjes / biznesit fillestar të tyre.	Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Transportit	Drejtoria e Buxhetit dhe Financës	2026 - 2030	Numri i sipërmarrjeve/bizneseve fillestare të grave të lehtësuara nga tarifat vendore matur cdo vit dhe ndarë sipas moshës, vendbanimit, etnisë, llojit të sipërmarrjes, etj.
1.3. Krijimi i lehtësirave infrastrukturore për zhvillimin e bizneseve të vogla/sipërmarrjeve të reja nga gratë dhe të rejat/rinjtë nga grupet e cënueshme me fokus të veçantë gratë dhe të rejat në zonat rurale. ³	Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Transportit	Drejtoria e Pronave Publike dhe Strehimit	2027 - 2030	Lista me asetet që mund të vihen në dispozicion për këtë qëllim, e përgatitur dhe miratuar. Modaliteti i vënies në dispozicion të aseteve i përcaktuar.

¹ Me gra/të reja nga grupe të cënueshme kemi parasysh gra/të reja kryefamiljare, viktime/të mbijetuara të dhunës dhe trafikimit, nga minoritetet etnike, në skemën e ndihmës ekonomike, etj., në përputhje dhe me përkufizimet për këto grupe në legjislacionin në fuqi, sidomo në ligjin për shërbimet e kujdesit shoqëror.

² Në përputhje dhe zbatim të rekomandimeve të KLSH 2024

³ Në përputhje dhe zbatim të rekomandimeve të KLSH 2024



				Mbështetja me asete, e ofruar për një numër të caktuar grash dhe të rejash/rinjsh.
1.4. Avokimi me qeverisjen qendrore për lehtësimin e detyrimeve të taksave dhe tatim-fitimit për bizneset e ngritura nga gratë në zonat rurale ⁴ dhe nga grupe të cënueshme.	Kabineti i Kryetarit	Institucionet vendore OJF Organizatrat ndërkombëtare	2026	Një listë me argumente për këtë kërkesë dhe të dhënat përkatëse për Bashkinë Elbasan e përgatitur dhe përcjellë në qeverisjen qendrore (MSHPV, AMVV, MFE)
1.5. Vazhdimi i mbështetjes financiare dhe infrastrukture për start-up për gratë në zonat rurale ⁵ dhe nga grupet e cënueshme, si dhe për të rejtat dhe të rinjtë, në të gjithë diversitetin e tyre, që kanë ide inovatore në fushën e sipërmarrjes.	Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Transportit	Drejtoria e Buxhetit dhe Financës AKPA OJF Organizatrat ndërkombëtare	2026 - 2030	Numri i grave, të rejave dhe të rinjve të mbështetur për start-up, ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, aftësisë, llojit të veprimtarisë, etj. ⁶
1.6. Afishimi në ambientet e bashkisë dhe të NJA-ve, si dhe në faqen e internetit të bashkisë, i kërkesave për vende pune të nxjerra nga AKPA, referimi i grave/burrave, të rejave/të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, për të marrë shërbimet në AKPA, si dhe informimi i grave të zonave rurale mbi këto shërbime nga punonjëset/punonjësit socialë të NJVNRR-ve	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Medias AKPA Agjencia e Shërbimeve Sociale	2025 - 2030	Listat e afishuara apo të publikuara çdo vit - Numri i personave të referuar në Zyrat e Punës, ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj.

⁴ Në përputhje dhe zbatim të rekomandimeve të KLSH 2024

⁵ Në përputhje dhe zbatim të rekomandimeve të KLSH 2024

⁶ "Tjetër vision" po mbështet (2025) me grante për start up 8 persona me një mbështetje fillestare 4,000 euro për person. Kjo praktikë do duhet të vijohet më tej, në bahkëpunim edhe me AKPA (fondet që ka për këtë qëllim) dhe me ndarje të buxhetit nga vetë bashkia për këtë qëllim, apo vënies në dispozicion të hapësirave (infrastrukturës).



1.7. Nënshkrimi një marrëveshje bashkëpunimi me AKPA për të gjitha aktivitetet në zbatim të këtij PVVBGJ, ku të përcaktohet edhe roli informues i punonjësve/punonjësve socialë të NJVNRR-ve.	Kabineti i Kryetarit	DMPS AKPA Agjencia e Shërbimeve Sociale	2025	Marrëveshja e nënshkruar
1.8. Rritja e kapaciteteve profesionale të të rejave dhe të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, e sidomos të zonave rurale, përmes programeve ekzistuese të formimit profesional, si dhe përmes fillimit të funksionimit të Zyrës së Karrierës ⁷ , duke respektuar parimet e barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjes.	Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës	AKPA QFP OJF Organizatrat ndërkombëtare	2025 - 2030	Numri i të rejave/rinjve të përfshirë në trajnime profesionale çdo vit, ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, llojit të programit, etj.
1.9. Mbështetja e pjesëmarrjes së grave dhe të rejave e të rinjve, veçanërisht të zonave rurale, në panairë të ndryshme vendore, rajonale, kombëtare e ndërkombëtare, duke aplikuar parimet e barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjes	Drejtoria e Politikave të Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore	Njësitë Administrative AKPA	2025 - 2030	Numri i grave/të rejave/rinjve të mbështetur/a, ndarë sipas moshës, vendbanimit, etnisë, produktit, llojit të panairit, etj.
1.10. Mbështetja e punëkërkuësve dhe punëkërkuësve të papunë, sidomos të zonave rurale, me programe të formimit profesional dhe punësimit në fushën e shërbimeve të kujdesit në familje	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	AKPA QFP OJF	2025 - 2030	Numri i personave të mbështetur ndarë sipas moshës, etnisë, llojit të programit, etj.
1.11. Takime informuese me fermeret dhe fermerët në lidhje me mbështetjen që ofrohet nga MBZHR dhe AZHBR	Drejtoria e Politikave të Bujqësisë, Mjedisit dhe Pyjeve	MBZHR AZHBR OJF Organizatrat ndërkombëtare	2025 - 2030	Numri i takimeve informuese të zhvilluara në vit, si dhe numri i pjesëmarrës/eve, ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, llojit të aktivitetit.

⁷ Ngritur me mbështetjen e RISI Albania dhe Helvetas



1.12. Asistimi i fermereve dhe fermerëve për të plotësuar aplikimet në lidhje me mbështetjen që ofrohet nga MBZHR dhe AZHBR	Drejtoria e Politikave të Bujqësisë, Mjedisit dhe Pyjeve	MBZHR AZHBR OJF Organizatat ndërkombëtare	2025 - 2030	Numri i fermereve dhe fermerëve të asistuar çdo vit për të aplikuar për mbështetjen që ju ofrohet, ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, llojit të aktivitetit, etj.
1.13. Administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti i bashkisë dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor.	Drejtoria e Politikave të Bujqësisë, Mjedisit dhe Pyjeve	MBZHR AZHBR OJF Organizatat ndërkombëtare	2025 - 2030	Numri i fermereve dhe fermerëve të mbështetur me grante në vit, ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, llojit të aktivitetit, etj.
1.14. Takime informuese me nxënës dhe nxënës të shkollave nëntë vjeçare dhe të mesme, sidomos në zonat rurale, mbi thyerjen e stereotipeve gjinore në punësim, si dhe shërbimet e punësimit dhe formimit profesional që ofrohen nga AKPA (përfshirë dhe programet e vetëpunësimit, mbulimin e shpenzimeve të transportit, bursa, programi i garancisë rinore, etj).	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	ZVA (këshillues/et në karrierë) QFP Shkollat profesionale OJF Organizatat ndërkombëtare	2025 - 2030	12 takime në vit 20 persona në çdo takim ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etj.
1.15. Trajnimi i punonjëseve/punonjësve të bashkisë dhe NJA mbi Konventën C190 të ONP-së dhe ngacmimet seksuale në vendin e punës.	Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore	DMPS ASPA OJF Organizatat ndërkombëtare	2026 - 2030	1 trajnim në vit me 12 persona, ndarë sipas seksit, moshës, pozicionit në bashki, etj.
1.16. Përfshirja në Kodin Etik i një seksioni për ngacmimin seksual në vendin e punës, ku të merren parasysh edhe standartet e Konventës C190 dhe të përcaktohet cili do jetë mekanizmi i mbështetjes dhe referimit për këto raste	Drejtoria Juridike dhe e Informacionit	Drejtoritë përkatëse të angazhuara për përgatitjen e kodit etik	2026	Seksioni në Kodin Etik i plotësuar në përputhje dhe me Konventën C190
1.17. Sesione orientuese/trajnuese (edhe online) për stafin e Bashkisë në lidhje me etikën, politikën,	Drejtoria e Administratës	Të gjitha drejtoritë	2026 - 2030	Të paktën 1 sesion në vit. Numri i



standartet e procedurat e funksioniit të bashkisë, sidomos për punonjëset dhe punonjësit që emërohen rishtazi apo që ndryshojnë pozicionin e punës	dhe Burimeve Njerëzore	përkatëse në bashki		punonjës/eve të informuar/a
1.18. Aktivitete informuese me nxënës dhe nxënës në shkolla, veçanërisht në zonat rurale, mbi rëndësinë e ndarjes së barabartë të punës dhe kujdesit të papaguar në familje, ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve. ⁸	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	ZVA OJF Organizatrat ndërkombëtare	2025 - 2030	18 takime në vit Numri i personave në çdo takim ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etj
1.19. Takime informuese me punonjëset dhe punonjësit e institucioneve private / bizneseve për të nxitur kërkimin e të drejtës për marrjen e lejeve të paguara, sidomos nga baballarët.	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	Inspektoriati i Punës	2026 - 2030	2 takimeve të zhvilluara çdo vit 20 persona në çdo takim ndarë sipas seksit, moshës, profesionit, etj
1.20. Podcast mbi format e lejeve të paguara, të lejueshme për secilin prind në legjislacionin shqiptar.	Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës	Universiteti Media lokale OJF	2027 - 2030	Numri i podcast-eve të zhvilluara
1.21. Publikimi i informacioneve të ndryshme në mediat sociale për të sfiduar stereotipet gjinore në punësim, për balancimin e jetës personale me atë profesionale, si dhe ndarjen e punëve e kujdesit në familje.	Drejtoria Juridike dhe e Informacionit	Universiteti Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale OJF	2025 - 2030	Linku me informacionet e publikuara çdo vit
1.22. Informimi i grave, të rejave e të rinjve që jetojnë në zonën nga kalon rruga Egnatia, mbi mundësitë e zhvillimit ekonomik përmes ngritjes së agrobizneseve, zhvillimit të turizmit familjar, etj.	Drejtoria e Politikave të Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore	AKPA OJF	2025 - 2027	Numri i personave të informuar, ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.
1.23. Mbështetja e grave dhe të rejave që fillojnë një aktivitet në rrugën Egnatia për brandimin e	Drejtoria e Politikave të	Drejtoria e Integritit	2027 - 2030	Standardet e brandimit të njohura

⁸ Në përputhje me aktivitetin I.1.3.h të SKBGJ 2021-2030



produkteve dhe përgatitjen e historikut mbi trashëgiminë, duke respektuar edhe kërkesat dhe standartet e BE.	Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore	Evropian, Projekteve dhe Donatoreve		15 gra/ të reja të mbështetura për brandim (5 në vit).
1.24. Aktivitete informuese me gra, si dhe të reja e të rinj në të gjithë diversitetin e tyre, mbi të drejtat pronësore të grave, përfshirë dhe të drejtat pronësore mbi tokën bujqësore.	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	OJF Organizatrat ndërkombëtare	2026 - 2030	2 takime në vit me 15 persona, ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etj.
1.25. Podcaste me tematikë të drejtat pronësore të grave, të rejave dhe vajzave, duke u fokusuar edhe te të drejtat pronësore mbi tokën bujqësore.	Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës	Universiteti OJF Institucionet përgjegjëse vendore	2027 - 2030	Numri i podcasteve të zhvilluara në vit
1.26. Sesione informuese falas për gratë, të rejat dhe vajzat me të ardhura të pamjaftueshme, e nga zonat rurale, mbi përdorimin e teknologjisë, digjitalizimin, të punuarit online, etj., përmes programeve përkatëse në QFP dhe një grupi me të reja dhe të rinj që angazhohen vullnetarisht për çështje të digjitalizimit dhe asitencës teknike në këtë drejtim	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	AKPA QFP Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës	2026 - 2030	1 kurs që zhvillohet çdo vit nga QFP dhe 2 sesione informuese falas nga Bashkia çdo vit
1.27. Ofrimi i shërbimeve të përkujdesit me orar të përkohshëm (psh 4 orë në ditë) në qendrat ekzistuese apo përmes programeve/qendrave të reja, të shtrira edhe në zonat rurale, për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara, për t'u krijuar mundësi për punësim kujdestar/eve të tyre	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale/Agjencia e Shërbimeve Sociale	Qendrat komunitare Qendrat shëndetësore të shëndetit mendor, OJF Organizatrat ndërkombëtare	2028 - 2030	Numri i personave me AK që marrin shërbime të përkujdesit ditor dhe numri i kujdestar/eve që lehtësohen dhe kanë mundësi të punësohen si rrjedhojë e kësaj mbështetjeje të ofruar



1.28. Bashkwpunimi mw AKPA pwr angazhimin e grave me AK në programet e punëve publike në komunitet (në zbatim të VKM përkatëse)	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale/Agjencia e Shërbimeve Sociale	AKPA QFP Institucionet vendore Inspektoriati i Punës OJF	2026 - 2030	Numri i grave me AK, të përfshira në programet e formimit profesional e të punëve publike në komunitet, ndarë sipas moshës, llojit të aftësisë së kufizuar, etj.
1.29. Përmirësimi i shërbimit të transportit publik në shtrirje gjeografike (veçanërisht për mbulimin e NJA të zonave rurale) ⁹ dhe afate kohore, si mundësi për lehtësimin e aksesit në tregun e punësç	Drejtoria e Planifikimit të Përgjithshëm dhe të Detajuar Urban	Partnerët që ofrojnë shërbimin e transportit	2027 - 2030	Shërbimi i traspotit publik i përmirësuar (shtrirë gjeografikisht dhe zgjatur në kohë)
1.30. Zbatimi i legjislacionit mbi fleksibilitetin në vendin e punës si një mundësi për balancimin e detyrave të kujdesit dhe punës së papaguar në familje mes grave dhe burrave	Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore	Drejtoria Juridike dhe e Informacionit	2026 - 2030	Grafiku i orareve fleksibël në vendin e punës për gratë dhe burrat punonjës/e të administratës së bashkisë dhe NJA
2. PJESËMARRJA DHE PËRFAQËSIMI NË VENDIMMARRJE				
2.1. Takime motivuese për nxitjen e pjesëmarrjes së grave dhe të rejave në vendimmarrje, të organizuara me praninë e vetë grave dhe të rejave që janë aktualisht në pozicione vendimmarrëse.	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	AGK OJF Organizatat ndërkombëtare	2026 - 2030	1 takimeve në vit me 15 gra/të reja, ndarë sipas moshës, vendbanimit, etj.
2.2. Trajnim i Aleancës së Grave Këshilltare (AGK) dhe Komisionit të Barazisë Gjinore (KBGJ) në lidhje me përfaqesimin, leadershipin, vendimmarrjen dhe barazinë gjinore.	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	OJF Organizatat ndërkombëtare	2025 - 2030	1 trajnim në vit me 15 anëtare, ndarë sipas moshës, pozicionit, etj
2.3. Fuqizimi i Këshillit Vendor Rinor duke shtuar në anëtarësinë e tij të reja dhe të rinj edhe nga zonat	Drejtoria e Arsimit,	DMPS	2026	Anëtarësia e KVR shtuar me të reja dhe të rinj në

⁹ Në përputhje me rekomandimin e KLSH 2024



rurale dhe grupet e pafavorizuara, si dhe duke respektuar barazinë gjinore në përfaqësim në këtë këshill.	Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës			të gjithë diversitetin e tyre dhe ku respektohen parimet e BGJ
2.4. Trajnime të të rejave dhe të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, sidomos nga zonat rurale, për formimin e aftësive udhëheqëse dhe drejtuese, si dhe adresimin në mënyrën e duhur të barazisë gjinore në vendimarrje.	Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës	DMPS OJF Organizatat ndërkombëtare	2026 - 2030	2 trajnime në vit me 15 persona, ndarë sipas seksit, moshës, etj.
2.5. Përfshirja e vazhdueshme e të rejave dhe të rinjve, sidomos nga zonat rurale, në proceset vendimarrëse të politikave rinore, sociale, të barazisë gjinore, fuqizimit ekonomik, zhvillimit urban e mjedisor dhe në çdo politikë tjetër të rëndësishme që harton bashkia	Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës	DMPS	2025 - 2030	2 takime në vit realizuar me të rejtat dhe të rinjtë, bazuar në proceset vendimarrëse të bashkisë Numri i të rejave dhe të rinjve të përfshirë në çdo takim, ndarë sipas seksit, moshës, etj.
2.6. Zbatimi i parimeve të barazisë gjinore në emërimet që bën bashkia në pozicionet drejtuese (veçanërisht Administratore/Administratorë në NJA), si dhe në emërimet e bordeve dhe komisioneve të përhershme	Kabineti i Kryetarit	Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore; Drejtoria Juridike dhe e Informacionit	2027 - 2030	Rregullore e rishikuar ku të theksohet zbatimi i parimeve të BGJ Numri i administratoreve gra të emëruara pas zgjedhjeve vendore
2.7. Aktivitete sensibilizuese kundër dhunës ndaj grave dhe të rejave në politikë dhe vendimarrje.	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	AGK OJF Organizatat ndërkombëtare	2026 - 2030	1 aktivitet në vit me 15 persona, ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etj
2.8. Trajnime me gazetaret e gazetarët në lidhje me mënyrën e paraqitjes së modeleve pozitive të grave,	Drejtoria e Mbrojtjes dhe	OJF Organizatav ndërkombëtare	2026 - 2030	1 trajnim në vit me 15 persona, ndarë sipas



të rejave e vajzave në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.	Përfshirjes Sociale			pozicionit, fushave që mbulojnë, etj.
3. DHUNA ME BAZË GJINORE				
3.1. Rinënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit për funksionimin e MKR dhe përfshirja e komuniteteve fetare si antare të MKR	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	Kabineti i Kryetarit Antarët e MKR	2026	Marrëveshja e rinovuar (rinovohet sipas nevojës edhe në vitet në vijim)
3.2. Organizimi i mbledhjeve të rregullta të Komitetit Drejtues të MKR	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	Antarët e MKR	2025 - 2030	2 mbledhje në vit me 15 persona
3.3. Organizimi i mbledhjeve të rregullta të ETN, mbledhje periodike dhe në varësi të rasteve	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	Antarët e MKR	2025 - 2030	12 mbledhje në vit me 15 persona
3.4. Vazhdimi i menaxhimit të rasteve me përparësi dhe efektivitet përmes koordinimit me ETN	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale/Agjencia e Shërbimeve Sociale	Anëtarët e MKR	2025 - 2030	Afërsisht 170 raste të menaxhuara në vit, ndarë sipas seksit, moshës, llojit të dhunës, etj.
3.5. Mbajtja e raporteve dhe dokumentacioneve të rregullta dhe dorëzimi i tyre (sipas kërkesës) në Gjykatë.	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale/Agjencia e Shërbimeve Sociale	Anëtarët e MKR	2025 - 2030	Numri i raporteve dhe dokumentacioneve dorëzuar në Gjykatë, çdo vit.
3.6. Prezenca e Koordinatorës/it Vendor dhe Punonjëses/it të Mbrojtjes së Fëmijëve, sipas kërkesës e detyrimit ligjor, në Gjykatë	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale/Agjencia e Shërbimeve Sociale		2025 - 2030	Numri i seancave ku KV dhe PMF janë prezent çdo vit, ndarë sipas rastit, llojit të dhunës etj.



3.7. Vazhdimi i monitorimit të rregullt të zbatimit të UM	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale/Agjencia e Shërbimeve Sociale	Antarët e MKR	2025 - 2030	Afërsisht 170 raste të monitoruara në vit dhe po aq raporte të dorëzuara në polici
3.8. Përditësimi i databazës rregullisht (REVALB) dhe ndarja e të dhënave me antarët e MKR sipas kërkesës	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	Anëtarët e MKR	2025 - 2030	Sistemi i plotësuar rregullisht
3.9. Fuqizimi i kapaciteteve të anëtarëve të MKR (vecanërisht anëtarët e rinj, si dhe strukturat e shëndetësisë për referimin e rasteve)	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	MSHMS ASPA Anëtarët e MKR	2025 - 2030	1 sesion mentorues në vit (sipas nevojës)
3.10. Bashkëpunimi me ZVAP për organizimin e aktiviteteve në kuadër të zbatimit të këtij PVVBGJ, si dhe për monitorimin e rolit të mediator/eve, psikolog/eve në shkolla, në lidhje me adresimin e çështjeve të BGJ.	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	ZVAP Shkollat Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës	2025 - 2030	2 takime çdo vit
3.11. Aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere me nxënëse/nxënëse, të reja / të rinjtë dhe komunitetin në tërësi, sidomos në zonat rurale, përgjatë gjithë vitit, mbi format e ndryshme të DHBGJ (përfshirë dhunën kibernetike, femicidin, trafikimin e qenieve njerëzore, martesat e hershme, etj)	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	MSHMS ZVA Shkollat Anëtarët e MKR OJF Organizatrat ndërkombëtare	2025 - 2030	2 aktivitete në vit me 20 pjesëmarrës/e ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etnisë, etj.
3.12. Organizimi i Fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit kundër DHBGJ	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	MSHMS ZVA Shkollat Anëtarët e MKR	2025 - 2030	1 fushatë e përvitshme



		OJF Organizatat ndërkombëtare		
3.13. Aktivitete të fokusuara veçanërisht te djemtë dhe burrat sidomos nga zonat rurale (takime, sesione mbi maskilizmin pozitiv, aktivitete në shkolla, etj).	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	ZVA Shkollat Antarët e MKR OJF Organizatat ndërkombëtare	2025 - 2030	1 aktivitet në vit, me 15 pjesëmarrës, ndarë sipas moshës, vendbanimit, etj.
3.14. Vazhdimi i ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara të strehimit emergjent, përmes mbështetjes financiare të OJF të specializuara	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale/ Agjencia e Shërbimeve Sociale DBF	OJF Organizatat ndërkombëtare	2025 - 2030	Shërbimi i strehimit emergjent i mbështetur financiarisht dhe i ofruar sipas standarteve
3.15. Mbulimi i nevojave për strehim afatgjatë të viktimave/ të mbijetuarave të DHBGJ përmes aplikimit të bonusit të qerasë (mbështetje për aplikantët në sqarimin dhe përshpejtimin e procedurave përkatëse)	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	OJF Organizatat ndërkombëtare	2025 – 2030	Afërsisht 30 viktimat/të mbijetuarat që përfitojnë çdo vit bonus qeraje
3.16. Shtimi i fondeve të nevojshme për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore, bazuar në ushtrimin e kostimit	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale / Agjencia e Shërbimeve Sociale DBF		2026 - 2030	% e fondit dedikuar për menaxhimin e rasteve të DHF dhe DHBGJ
3.17. Vazhimi i ofrimit të shërbimeve për burrat dhunues, përmes bashkëpunimit dhe mbështetjes financiare të OJF përkatëse, duke eksploruar dhe	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	OJF Organizatat ndërkombëtare	2025 - 2030	Numri i burrave dhe të rinjve dhunues të trajtuar në këto shërbime



mundësinë e ofrimit të shërbimit në paraburgim apo me të dënuarit që vuajnë dënimin në burg				% e kostos së shërbimit që mbulohet nga bashkia
3.18. Përfshirja në Fakultetin e Shkencave të Edukimit i moduleve për të punuar me djemtë dhe burrat në përgjithësi, si dhe me dhunuesit.	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	2026	Moduli i përfshirë
3.19. Aktivitete informuese sidomos në zonat rurale, mbi trafikimin e qenieve njerëzore.	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	Shkollat OJF Organizatat ndërkombëtare	2025 – 2030	1 fushatë çdo vit
3.20. Takime dhe këshillime/ sesione mbi prindërimin pozitiv në qendra komunitare me fokus të veçantë zonat rurale (edhe me të moshuarat/moshuarit)	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale/ Agjencia e Shërbimeve Sociale	OJF Organizatat ndërkombëtare	2025 – 2030	4 kurse prindërimi çdo vit, me prindër dhe gjyshe/gjyshër ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.
3.21. Përgatitja e një materiali informues mbi legjislaconin, të drejtat dhe detyrimet në lidhje me martesën dhe familjen, për t’u përdorur për këshillimin e çifteve përpara celebrimit (duke evidentuar edhe pasojat e martesave të djemve të rinj me gra më në moshë, për shkak të marrjes së mbiemrit), informacion mbi planifikimin familjar, etj.	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale/ Agjencia e Shërbimeve Sociale	Universiteti OJF Organizatat ndërkombëtare	2025	Materiali i përgatitur
3.22. Trajnimi i punonjëseve dhe punonjësve të gjendjes civile, NJVNRR-ve, qendrave komunitare, si dhe NJA për të shpërndarë informacionin për këshillimin e çifteve përpara celebrimit.	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale/ Agjencia e Shërbimeve Sociale	Universiteti OJF Organizatat ndërkombëtare	2026 - 2030	1 trajnim në vit me 15 persona, ndarë sipas seksit, moshës, pozicionit, etj.
3.23. Trajnimi i anëtarëve/anëtarëve të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike për Rezolutën 1325, planin	Drejtoria e Mbrojtjes dhe	KVSP OJF	2025 – 2030	Numri i trajnimeve në vit dhe numri i



e veprimit për agjendën “Gruaja, paqja dhe Siguria, si dhe për barazinë gjinore	Përfshirjes Sociale	Organizatrat ndërkombëtare		pjesëmarrës/eve, siç do parashikohet në Planin Vendor të Sigurisë
3.24. Trajnimi i të rejave dhe të rinjve për të qenë pjesë e auditeve të sigurisë në hapësirat publike dhe për adresimin në mënyrën e duhur të çështjeve të sigurisë dhe barazisë gjinore	Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës	OJF Organizatrat ndërkombëtare	2025 – 2030	1 trajnim në vit me 15 persona , ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.
3.25. Takime në NJA dhe lagje, me fokus të veçantë zonat rurale, me gra, të reja, vajza, burra, të rinj dhe djem për të diskutuar mbi nivelin e sigurisë/pasigurisë që kanë në hapësirat publike.	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	Anëtarët e KVSP	2026 - 2030	Numri i takimeve të zhvilluara, siç do parashikohen në Planin e Sigurisë
3.26. Kryerja e misionëve të auditit të sigurisë në lagjet e Elbasanit dhe në NJA, me fokus të veçantë zonat rurale.	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	Anëtarët e KVSP	2026 - 2030	Numri i misionëve të zhvilluara, siç do parashikohet në Planin Vendor të Sigurisë
3.27. Shtimi i elementëve të sigurisë në hapësirat publike dhe rrugët e planifikuara për rikonstrukcion, sidomos në zonat rurale (ndriçim i plotë, kamera të sigurisë, tabela dhe sinjalistika, etj).	Drejtoria e Planifikimit të Përgjithshëm dhe të Detajuar Urban	Anëtarët e KVSP	2026 - 2030	Në vazhdimësi sipas nevojave dhe ndërhyrjeve infrastrukturore, siç do parashikohet në Planin Vendor të Sigurisë
3.28. Trajnime të të rejave dhe të rinjve, me fokus të veçantë nga zonat rurale, për agjendën e paqes, sigurisë dhe barazisë gjinore	Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës	OJF Organizatrat ndërkombëtare	2026 – 2030	2 trajnime në vit me 15 persona , ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.
3.29. Organizimi i aktiviteteve mbi paqen, sigurinë dhe barazinë gjinore nga vetë të rejtat dhe të rinjtë.	Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit,	DMPS OJF Organizatrat ndërkombëtare	2026 – 2030	3 aktivitete në vit



	Migracionit dhe Diasporës			
3.30. Angazhimi i fëmijëve të familjeve ku ushtrohet dhunë, në aktivitete sportive, artistike e kulturore, si mundësi për të trajtuar stresin dhe traumën e shkaktuar nga dhuna	Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale Shkollat OJF	2026 - 2030	Numri i fëmijëve të familjeve ku është ushtruar dhunë, të angazhuar në aktivitete artistiko-kulturore, ndarë sipas seksit, moshës, etj.
4. INTEGRIMI GJINOR				
4.1. Takime informuese për nxitjen e pjesmarrjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, sidomos nga zonat rurale, në dëgjesa publike, duke vlerësuar mendimin e tyre.	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	DFB OJF Organizatat ndërkombëtare	2025 - 2030	2 takime në vit me 15 gra, ndarë sipas moshës, etnisë, etj.
4.2. Përdorimi i gjuhës së ndjeshme gjinore në dokumentet zyrtare dhe faqet e internetit të bashkisë.	Drejtoria Juridike dhe e Informacionit	DMPS Të gjitha drejtoritë në Bashki	2025 - 2030	Numri i dokumenteve të bashkisë ku përdoret gjuhë e ndjeshme gjinore
4.3. Përfshirja e NBGJ në GMS si dhe në të gjitha grupet e punës për hartimin e strategjive dhe planeve të veprimit të bashkisë, me qëllim integrimin gjinor në këto dokumenta.	Kabineti i Kryetarit	Të gjitha drejtoritë në Bashki	2025 - 2030	Urdhri për përmirësimin e rregullores për grupet e punës Numri i strategjive apo planeve të bashkisë me perspektivën gjinore të integruar
4.4. Ngritja e një Komisioni për Barazi Gjinore/Grup monitorimi në nivel bashkie (për koordinim të zbatimit të këtij PVVBGJ dhe bashkëpunim me Komisionin e BGJ në nivel të Këshillit Bashkiak)	Kabineti i Kryetarit	Të gjitha drejtoritë në Bashki	2025	Urdhri për ngritjen e komisionit
4.5. Takime të rregullta të Komisionit për BGJ/GM në nivel bashkie për mbarëvajtjen e zbatimit të PVVBGJ	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	Antar/et e Komisionit të BGJ/GM në bashki	2025 - 2030	2 takime në vit



4.6. Fuqizimi i kapaciteteve të specialistes/specialistit të statistikave dhe punonjëseve / punonjësve të sektorëve të tjerë për plotësimin e tabelave me treguesit gjinorë.	Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore	ASP OJF Organizat at ndërkombëtare	2025 - 2030	Të paktën 1 sesion mentorues në vit
4.7. Trajnime mbi Integrimin Gjinor, Vlerësimin e Ndikimit Gjinor, Analizën Gjinore të Programeve Buxhetore dhe Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor.	Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore	ASP OJF Organizat at ndërkombëtare	2026 - 2030	2 trajnime në vit me 15 persona, ndarë sipas seksit, moshës, pozicionit në bashki, etj.
4.8. Analiza gjinore e programeve buxhetore të bashkisë	Drejtoria e Buxhetit dhe Financës	Të gjitha drejtoritë në Bashki	2027 - 2030	1 program buxhetor i analizuar në vit
4.9. Trajnimi i stafit të bashkisë dhe institucioneve publike mbi ndryshimet ligjore të Ligjit për Barazinë Gjinore (pas miratimit të draft ligjit të ri)	Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore	ASP OJF Organizat at ndërkombëtare	2026 - 2030	Të paktën 1 trajnim në vit me 15 persona, ndarë sipas seksit, moshës, pozicionit në bashki, etj.
4.10. Organizimi i aktiviteteve mbi barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në kuadër të Ditës (javës) Ndërkombëtare të Gruas, me fokus të veçantë zonat rurale	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	Shkollat OJF Organizat at ndërkombëtare	2025 - 2030	Të paktën 1 aktivitet në vit
4.11. Shtimi i një seksioni (apo faqeje të dedikuara) për barazinë gjinore në faqen e internetit të bashkisë dhe përditësimi rregullisht i informacionit në të.	Drejtoria e Teknologjise se Informacionit dhe Medias	Të gjitha drejtoritë në bashki	2026 - 2030	Seksioni i dedikuar i hapur dhe me informacion të përditësuar rregullisht
4.12. Trajnimi i stafit të bashkisë mbi monitorimin e brendshëm të zbatimit të PVVBGJ-së përmes mbledhjes së të dhënave dhe përdorimit të një formati raportimi të unifikuar	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale	Organizat at ndërkombëtare	2025 - 2027	Të paktën 1 sesion trajnues në vit
4.13. Hartimi i raporteve periodike vjetore mbi progresin në zbatimin e PVVBGJ	Komisioni i BGJ në nivel Bashkie	Të gjitha drejtoritë përgjegjëse	2025 - 2030	Një raport në vit
4.14. Vlerësimi i zbatimit të PVVBGJ pas tre viteve dhe rishikimi/përshtatja sipas nevojës	Komisioni i BGJ në nivel Bashkie	Të gjitha drejtoritë përgjegjëse	Fillimi i vitit 2028	Një raport vlerësimi



5.TË TJERA				
5.1. Aktivitete informuese me të rejat dhe gratë, sidomos nga zonat rurale, në kuadër të muajit “Tetori Rozë”	Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës	NJVKSH QSH OJF Organizatrat ndërkombëtare	2025 - 2030	1 fushatë në vit
5.2. Takime informuese me të reja dhe të rinj, sidomos nga zonat rurale, për rrezikun e përdorimit të substancave të varësisë dhe shërbimet që ofrohen në këtë drejtim	Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës	ZVA Shkollat NJVKSH QSH OJF Organizatrat ndërkombëtare	2025 – 2030	2 takime në vit me 15 persona, ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.
5.3. Takime informuese për shëndetin seksual e riprodhues me të rejat dhe të rinjtë, sidomos nga zonat rurale	Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës	DARS ZVA Shkollat OJF Organizatrat ndërkombëtare	2026 - 2030	2 takime në vit me 15 persona, ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.
5.4. Takime informuese për shëndetin mendor, me gra, burra, të reja, të rinj, vaja e djem, në të gjithë diversitetin e tyre, sidomos nga zonat rurale.	Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës	NJVKSH QSH DARS ZVA Shkollat OJF Organizatrat ndërkombëtare	2026 - 2030	2 takime në vit me 15 persona, , ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.
5.5. Shtimi i shërbimeve të përkujdesit (cerdhe, kopshte) sidomos në zonat rurale, për fëmijët vajza dhe djem,	Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit,	DBF	2026 - 2030	Numri i shërbimeve të përkujdesit që shtohen çdo vit



si një mundësi për t'u krijuar nënave më shumë hapësirë për t'u integruar në tregun e punës ¹⁰	Migracionit dhe Diasporës			
5.6. Trajnimi i edukatoreve të cerdheve dhe kopshteve për edukimin e ndjeshëm gjinor dhe mbrojtjen e fëmijëve vajza e djem nga dhuna dhe abuzimi	Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës	DSHKS OJF Organizatrat ndërkombëtare	2026 - 2030	2 trajnime në vit me 15 edukatore
5.7. Vazhdimi i evidentimit dhe mbështetjes së vajzave dhe të rejave që përfshihen në sporte "jo tradicionale për to" (promovimi i skuadrës së futbollit për vajzat, etj).	Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës	OJF	2025 - 2030	Numri i vajzave, të rejave, grave të promovuara, mbështetja e ofruar, % e fondeve në dispozicion, etj
5.8. Mbështetja e aktiviteteve kulturore dhe artistike që promovojnë fuqizimin e grave, të rejave dhe vajzave, sidomos nga zonat rurale dhe sfidojnë stereotipet gjinore.	Drejtoria e Politikave të Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore	OJF	2025 - 2030	Numri i aktiviteteve kulturore dhe artistike të zhvilluara me këtë tematikë
5.9. Emërtimi i rrugëve me emra të figurave të grave, të rejave dhe të rinjve, që kanë dhënë kontribut në Elbasan	Drejtoria e Planifikimit të Përgjithshëm dhe të Detajuar Urban	Kabineti i Kryetarit	2026 – 2030	Sipas investimeve në rrugë dhe infrastrukturë
5.10. Publikimi i historive të grave të shquara dhe burrave të shquar ndër vite në Elbasan	Drejtoria e Politikave të Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore	OJF Organizatrat ndërkombëtare	2027	Publikimi i përgatitur dhe i aksesueshëm online

¹⁰ Në përputhje me rekomandimet e KLSH 2024